
**STATUTI
I SHOQERISE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ELNASR” SHPK**

نام

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ELNASR” SHPK

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ELNASR” Sh.p.k, që këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”, zoterohet nga ortaku:

- 1- NASR MOHAMED EID SOLIMAN**, atesia **MOHAMED**, shtetas EGJIPTIAN, lindur me 31/12/1965 ne SHARKIA, identifikohet nepermjet pasaportes Nr.A22303449;

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë Statut të shoqërisë “ELNASR” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

KAPITULLI
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,
SELIA, TERRITORI

NENI 1
FORMA DHE EMRI

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale Sh.P.K., të cilat vijnë përpara ose menjëhere pas emrit të shoqërisë. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë.

1.2 Emri i shoqërisë është “ELNASR” Shpk

1.3 Forma dhe emri i shoqërisë mund të ndryshohen me vendim të Asamblese së Pergjithshme të Ortakeve.

NENI 2
BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, në përputhje me legjislacionin shqiptarë në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

NENI 3
SELIA

Selia e shoqërisë është ne adresen: Rruga “GLAUKIA” Lagja 17,Brenda

el

Ambienteve te Tregut Industrial, Durres, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4 TERRITORI

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyrat, filialet ose përfaqesite e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të zhvillojnë veprimtarine e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria "ELNASR" Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të konsulences dhe sherbimeve ndaj shoqerive ne Republikën e Shqiperise dhe ne territoret e tjera dhe ka si objekt të veprimtarise së saj:

5.1 RESTORANT ,SUPERMARKET.

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve te ndryshme. Pjesmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojne përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

NENI 6 KOHEZGJATJA

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedure likujdimi me vendim të Asamblese së Ortakeve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

نام

KAPITULLI III KONFIDENCIALITETI,

DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET

NENI 7

KONFIDENCIALITETI

Ortakët e shoqërise si dhe personat e tjere të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojne asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhe, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 8

DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojne lexueshem emrin e shoqërise dhe pas tij fjalet "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose inicialet "Sh.P.K.", si dhe emrin e administratorit ose te administratorëve.

KAPITULLI IV

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRASFERIMI I TYRE

NENI 9

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndare në 1 pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

- | | | |
|-----------|---------------------------------|----------------|
| 1. | NASR MOHAMED EID SOLIMAN | 100,00% |
|-----------|---------------------------------|----------------|

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 10

TE DREJTAT E ORTAKEVE NE LIDHJE ME KAPITALIN

10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e $\frac{3}{4}$ (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.

10.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar, i perket ortakeve e drejta me opcion mbi kapitalin ne zmadhim, ne proporcion me kuoten e kapitalit qe kane ne pronesi.

Nese ndonjeri nga ortakët nuk do te nenshkruaj kuoten e tij te kapitalit ne zmadhim, e

pl

drejta e opcionit do ti perkase ortakeve te tjere.
Duke mos e ushtruar ortakët të drejtën e opcionit, kapitali në zmadhim i panëshkruar do te nënshkruhet nga palë të treta.

10.3 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërise shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

10.4 Kuotat e kapitalit të shoqërise nuk mund të rendohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përmbushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra përbarimore ose ndonjë organ tjetër kompetent), duhet të ketë në konsiderate respektimin e kërkesave të nenit 13 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin ti shpjegoje neni 13 të këtij statuti subjektit në favor të cilit vendoset barra siguroese.

10.5 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesemarrjes ne kapital.

10.6 Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërise kanë të drejtë t'i kërkojne organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërise, si dhe të konsultojne dokumentet kontabel e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

NENI 11

FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Fusha e autoritetit të ortakëve, përqindja e fitimeve ose humbjeve do te kene si kriter bazë kontributin e çdo ortaku në kapitalin e shoqërise, si dhe kompetencat që gezon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

NENI 12

FINANCIMI I SHOQERISE

12.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkoje nga ortakët fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërise.

12.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve do të jene me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

NENI 13

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

13.1 Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të trasferohen lirisht mes ortakeve të shoqërise. Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të trasferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërise në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtes së parablerjes.

pl

13.2 Trasferimi i kapitalit themeltar të shoqërise ose i pjeseve të tij tek persona të tretë bëhet vetëm në këtë mënyrë:

- Oferta për shitje u drejtohet të gjithë ortakëve me shkrim;
- Oferta duhet të përcaktojë numrin e kuotave që shiten dhe çmimin e tyre;

Nëse ortakët e shoqërise brenda 3 (tre) muaj nga oferta me shkrim nuk pranojnë blerjen e kuotave të ofruara me çmimin e përcaktuar, atëherë konsiderohet se ata lejojnë shitblerjen tek të tretët.

13.3 Kapitali themeltar është lirisht i trashëgueshem në rrugë trashigimie. Bashkshorti, paraardhësit dhe pasardhësit mund të bëjnë ortakë nëpërmjet transferimit të pjeseve të kapitalit themeltar sipas kushteve që lejohen në ligj.

13.4 Transferimet e pjeseve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me akt noterial dhe të depozitohen në organin kompetent.

13.5 Klausolë miratimi. Nëse asnjë ortak nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes në kohë dhe sipas kushteve të parashikuar për transferimin e kuotave apo të drejtën e opcionit, kalimi i kuotave nuk do të mund të bëhet pa pëlqimin e Asamblese së Ortakëve që vendos për pranimin e transferimit të një personi të tretë. Ortakët mbledhen jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë, nëpërmjet Asamblese të Zakonshme të Ortakëve, duke vendosur me votën pro (në favor) me të paktën gjysmën e kapitalit themeltar.

13.6 Pëlqimi mund të refuzohet vetëm kur blerësi nuk jep garanci të mjaftueshme rreth kapaciteteve financiare ose për kushtet objektive o për aktivitetin që kryen, të tilla që hyrja e tij në shoqëri mund të jenë e dëmshme për arritjen e objektivave nga shoqëria ose konflikt me interesat e shoqërisë apo të ortakëve të tjerë. Asambleja e Ortakëve duhet të njoftojë me shkrim në adresën që rezulton vendimin për miratim.

Nëse brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës për miratim ortaku kërkues që nuk ka marrë asnjë komunikim miratimi do të konsiderohet si i dhënë dhe ortakët mund të transferojnë kuotën e tyre.

13.7 Nëse miratimi i mohohet do të prezantohet një tjetër blerës. Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakëve duhet të tregojë në letrën e refuzimit emrin e blerësit të propozuar; transferimi duhet të plotësohet me të njëjtat kushte të përcaktuara në kërkesën për miratim nga ana e aplikantit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas marrjes së komunikimit të fundit.

Përndryshe, ortaku do të jetë i lire për të shitur pjesëmarrjen e tij personit që konsideron me të përshtatshëm.

pi

KAPITULLIV

ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 14

ORGANET DREJTUESE

14.1 Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësoje shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise do ti referohemi me termin Asamble e Ortakëve.

14.2 Shoqëria mund të emeroje më shumë se një Administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" perdoret për të përcaktuar Administratorin e shoqërise "ELNASR" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë Administratoret e saj sado qofshin këta në numer.

14.3 Përveç organeve të parashikuara me sipër Asambleja e Ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre.

14.4 Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emëruar
ERISTIN LLESHI .

KAPITULLI VI

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

NENI 15

VENDIMET E ASAMBLESE TË ORTAKEVE

15.1 Asambleja e Ortakëve vendos për çështjet që ligji apo ky statut i rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakëve.

15.2 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 % të kuotave të kapitalit themeltar.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas ligjit mbi shoqëritë tregtare, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 75 % të numrit total të kuotave të kapitalit themeltar janë të pranishëm dhe vendosin me votën e $\frac{3}{4}$ (tre të katertave).

NENI 16

KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKEVE

16.1 Në përputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakëve mund të merren pas një konsultimi me shkrim që organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Në këtë rast, organi administrativ i komunikon ortakëve tekstin e projekt-vendimit që do të merret

eli

dhe i kerkon te shprehin vullnetin e tyre ne lidhje me kete çeshtje.

16.2 Vendimet e marra ne kete menyre jane te vlefshme kur vendimi merret nga shumica qe ligji apo ky statut kerkon per ate çeshtje.

NENI 17

MENYRA DHE VENDI I THIRRJES I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

17.1 Asambeja e Ortakeve thirret prane selise se shoqerise, apo ne ndonje vend tjeter brenda Republikes se Shqiperise, nepermjet nje njoftimi me shkrim edhe nepermjet postes elektronike (E-mail), duke e konfirmuar marrjen, qe iu dergohet ortakeve nga Kryetari i Asamblese se Ortakeve dhe / ose Organi Administrativ.

17.2 Njoftimi i thirrjes se mbledhjes se asamblese duhet te kryhet 15 (pesembedhete) dite perpara dates se mbledhjes dhe duhet te percaktoje shprehimisht daten, oren, vendin si dhe rendin e dites. Ne rast pamundesie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblese se ortakeve mund te thirret nga esperti kontabel i autorizuar, nese ka te tille, ose nga nje apo me shume ortake, te cilet perfaqesojne jo me pak se 10% te kapitalit te shoqerise.

NENI 18

KRYETARI I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

18.1 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve emeron Kryetarin e Asamblese.

18.2 Kryetari i Asamblese verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt te Asamblese se Ortakeve, verteton identitetin apo legjitimimin e perfaqesuesit te ortakeve dhe drejton zhvillimin e rregullt te mbledhjes.

نام

NENI 19
PJESEMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak ka te drejten e nje vote per çdo kuote te kapitalit themeltar te shoqerise qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjen e asamblese nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete, nepermjet nje akti perfaqesimi me shkrim.

NENI 20
KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

20.1 Asambleja e Ortakeve mund te jete e zakonshme dhe e jashtezakonshme, kjo ne varesi te çeshtjes per te cilen eshte thirrur. Vendimet e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve merren me shumice te thjeshte te votave te ortakeve. Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve merren me nje shumice te cilesuar prej $\frac{3}{4}$ (tre te katertave) te votave te ortakeve te shoqerise. Per çfare nuk eshte pasqyruar ne kete nene, Asambleja e Ortakeve te shoqerise vendos ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14. 04. 2008.

20.2 Kompetencat e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve do te jene:

- Vendos per perpilimin ose miratimin e rregulloreve per shoqerine apo per fusha te veçanta te veprimtarise.
- Vendos per ndryshimin e selise se shoqerise.
- Vendos per krijimin e zyrave ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive ose te ortakerive me persona te tjere fizike apo juridike.
- Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise, ekspertin kontabel, likujdatori duke percaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, te drejttat, detyrimet, kohezgjatjen ne detyre, dhe shperblimin e tyre.
- Vendos ne lidhje me krijimin e organeve te tjera drejtuese qe mund t'i nevojiten shoqerise duke percaktuar ne aktet e krijimit te ketyre organeve, kohezgjatjen dhe kompetencat e tyre, per emerimin e personave drejtues te ketyre organeve.
- Asambleja e Ortakeve marrjen e vendimeve e kryen vete dhe nuk ben delegimin e vendimarrjes te asnje organ tjeter. Asambleja e Ortakeve vendos edhe ne lidhje me krijimin e sektoreve te veçante te veprimtarise se shoqerise.
- Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor.
- Miraton tarifat e sherbimeve te shoqerise.
- Miraton pagat e te punesuarve ne shoqeri.

20.3 Kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve jane:

- Vendos ne lidhje me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Vendos ne lidhje me kohezgjatjen e shoqerise si dhe per mbarimin e likujdimin e saj.
- Vendos per ndryshimin e emrit te shoqerise.

pl

- Vendos ne lidhje me ndryshimin e statutit te shoqerise.
- Vendos per ndryshimin e formes, per ndarjen e shoqerise si dhe per bashkimin e saj me shoqeri te tjera.
- Percakton llojin e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, percaktimin e dividendit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.
- Realizon marredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te shoqerise me persona te tjere fizik apo juridik, vendas apo te huaj.
- Vendos ne lidhje me transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.

20.4 Pervec kompetencave te lartpermendura, te cilat jane ekskluzive per te, Asambleja e Ortakeve ushtron çdo kompetence qe ia njeh ligji.

20.5 Asambleja e Ortakeve ne rastet kur nuk ka emeruar Administrator, kryen dhe kompetencat qe ne kete Statut jane percaktuar per kete te fundit. Gjithashtu Asambleja e Ortakeve mund te kufizojë Administratorin ne ushtrimin e kompetencave te tij.

NENI 21

ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

21.1 Kompetencat e Administratorit ose te Administratoreve, te cilet mund edhe te mos jene ortake te shoqerise, ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Veç te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, Administratori ka edhe keto kompetenca:

- Kujdeset per funksionimin e perdritshem normal te shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet Asamblese se Ortakeve per shqyrtim.
- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne shoqeri.
- Ndjek problemet e shoqerise ne marredhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon Asamblese se Ortakeve tarifat e sherbimeve dhe pagat per personelin e punesuar ne shoqeri.
- I propozon Asamblese se Ortakeve rregulloren e shoqerise.
- Administratoret kane te drejte te gjithe sebashku ose vecmas nga njeri tjetri te perfaqesojne shoqerine ne lidhje me te tretet.

21.2 Administratori ose Administratoret jane pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate ushtrimit te administrimit te shoqerise. Pergjegjësia eshte individuale ose solidare, kjo ne varesi te rrethanave dhe te menyres se si eshte vepruar, pra individualisht ose solidarisht.

Handwritten signature

21.3 Administratori o Administratoret nuk jane pergjegjes ndaj shoqerise ose te treteve per konfliktin e interesit qe mund te krijohet duke zhvilluar pozicione te ndryshme ose te ngjashme ne shoqeri dhe organizma te ndryshem.

KAPITULLI VII **KONTROLLI KONTABEL,** **BILANCI, DIVIDENTET**

NENI 22 **KONTROLLI KONTABEL**

Kontrolli i jashtem kontabel i shoqerise kryhet nga eksperte kontabel te autorizuar, sipas legjislacionit ne fuqi. Asambleja e Ortakeve do te emeruje nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

NENI 23 **BILANCI DHE REZERVAT**

23.1 Bilanci mbyllet ne 31 dhjetor te çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar, i paraqiten per shqyrtim asamblese se ortakeve, e cila vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrezimin e ketyre akteve, kur e konsideron te nevojshme Asambleja e Ortakeve mund te beje rekomandimet e nevojshme ne lidhje me çeshtjen ne diskutim.

23.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori i vetem merr masat e nevojshme per hartimin e projekt-bilancit te aktivitetit per vitin financiar te mbyllur, ne menyre qe Asambleja e Ortakeve te vendose mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve te percaktuara nga ligji.

23.3 Asambleja e Ortakeve vendos mbi ndarjen ndermjet ortakeve te shumave qe rezultojne si fitime sipas bilancit te aprovuar rregullisht, pasi nga keto shuma te jene zbritur humbjet e mundshme te viteve te meparshme, si dhe te jene lene menjane shumat e nevojshme per krijimin e rezerves ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nepermjet lenies menjane te nje shume te barabarte me 5 % te fitimit neto te realizuar gjate secilit vit financiar, deri sa te arrihet nje shume e barabarte me 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

23.4 Asambleja e Ortakeve ne çdo moment mund te vendose krijimin e rezervave te tjera, si dhe masen e tyre.

KAPITULLI VIII **MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE,**

نا

LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

NENI 24 MBARIMI

Shoqëria mbaron me vendim të Asamblese së Jashtëzakonshme të Ortave ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

NENI 25 LIKUJDIMI

25.1 Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja e Ortave cakton një ose disa likuidues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të perfundimit të tyre.

25.2 Në fund të procesit të likuidimit, Asambleja e Ortave vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit.

25.3 Mbas pagimit të kreditorëve Asambleja e Ortave mban pjesën e mbetur të kapitalit që u shpërndahet ortave.

NENI 26 LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

26.1 E drejta e largimit lejohet në rastet e parashikuara me ligj.

Njoftimi i largimit duhet të dërgohet shoqërisë me shkrim dhe duhet të përfshijë emër mbiemër të ortakut që largohet, vendbanimin, për komunikimet e nevojshme mbi procedurën e largimit dhe numrin e kuotave në lidhje me të cilat synon të largohet motivimet përkatëse.

Ortakët që largohen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin një rimbursim të kuotave në proporcion të kapitalit të shoqërisë. Për këtë qëllim është përcaktuar duke marrë parasysh vlerën e tij të llogaritur në bazë të kapitalit neto.

26.2 Shlyerja e kuotave për të cilën është ushtruar e drejta e largimit duhet të bëhet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga komunikimi që i bëhet shoqërisë. Ajo gjithashtu mund të bëhet me anë të blerjes nga ortakët e tjerë në proporcion me pjesëmarrjen e tyre ose nga një palë e tretë të identifikuar në mënyrë unanime nga ortakët. Për këtë qëllim, administratorit i kërkohet që të njoftojë ortakët e tjerë mbi mbarëvajtjen e procedurës së largimit të ortakut, dhe t'ia ofrojë për shitje, në emër dhe për llogari të ortakut që largohet, pjesën mbi të cilën është ushtruar largimi, duke deklaruar çmimin e kuotes dhe afatin për pagesën e saj, jo më shumë se 3 (tre) muaj. Për shitjen zbatohen rregullat mbi ushtrimin e së drejtës të parablerjes në këtë Statut.

26.3 Ortakët duhet të informojnë shoqërinë për qëllimin e tyre për të blerë kuotat e ortakut që largohet ose emrin e palës së tretë blerëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga

ناظر

marrja e komunikimit nga shoqëria dhe qëllimin e ortakut për t'u larguar. Nëse oferta është pranuar nga shumica e ortakëve, pjesa e ortakut që largohet do të ndahet në proporcion midis ortakëve në baze të kuotave përkatëse që kanë në kapitalin themeltare.

Nëse kjo nuk ndodh, rimbursimi do të bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme ose në mungesë përkatësisht zvogëlimin e kapitalit; nëse nuk është e mundur një rimbursim i kuotave të ortakut që largohet, atëherë shoqëria vendoset në likuidim.

26.4 Përrjashtimi i ortakut mund të bëhet, në rast të vonesës apo pamundësisë së kryerjes të punës ose shërbimeve që mund të kryhen nga një ortakë.

Përrjashtimi duhet të përcaktohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve me tre të katërtat e votave.

Pas zbulimit të vendimit për të përrjashtuar ortakun, ky i fundit është i penguar për të ushtruar të drejtat shoqërore.

26.5 Për likuidimin e kuotës të ortakut që largohet, aplikohet procedura e rimbursimit e parashikuar për largimin, përrjashtuar këtu mundësia e shlyerjes së kuotës nëpërmjet reduktimit të kapitalit themeltare dhe likuidimin e mundshëm të shoqërisë.

Përrjashtimi mund të revokohet, derisa kuota e ortakut të përrjashtuar nuk i është rimborsuar.

KAPITULLI IX

MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 27

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Çdo mosmarreveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kesaj shoqërie, ortakët do të angazhohen se do ta zgjidhin me mirekuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarreveshjeve a konflikteve të mundshme do të jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 28

DISPOZITA TE FUNDIT

28.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptarë. Për sa nuk është parashikuar në kete Statut, do të aplikohen dispozitat e legjisllacionit shqiptarë në fushën e shoqërive tregtare si dhe legjisllacioni shqiptarë në përgjithsi.

28.2 Shoqëria do të kete vulën, stemen, logon dhe faqen e internetit (website), format dhe madhësitë do të përcaktohen nga asambleja e ortakëve në veçanti dhe me propozim të administratorit.

pi

28.3 Ky Statut eshte hartuar ne 3 (tre) ekzemplare, duke patur secili ekzemplare fuqi te njejte ligjore.

Tirane, 26/10/2019

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
"ELNASR" SH.P.K.**

NASR MOHAMED EID SOLIMAN

